



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 2499 – 121/C1036
14 Nr. 400/25
Dt. 30.05.2025

KONTRATË FURNIZIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Messer Medica L.L.C.**“ me seli në Obiliq, me ARBK: 811452838, si **Operatorë Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Arbër Merovci**, në tekstin e mëtejshëm **KONTRAKTUESI – FURNIZUESI** , janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi – blerja e Oksigjenit – Gas medicinal për nevoja të QKMF-re , me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	24	9	9	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	1	6	1	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me bombola oksigjeni – Gas medicinal për nevoja të QKMF-re, sipas Përshkrimit të Artikujve dhe Çmimeve si dhe / ose Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-016-121**
- 1.2 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data: **30.05.2025** dhe përfundon më së largu deri më dt. **29.05.2028** duke përfshirë edhe këtë datë.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të parapara, si në pjesën II. Lista e Artikujve dhe Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Furnizuesit) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mundë të lejohet një mospërputhje e cila nuk mundë të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).
- 1.5 Nëse Urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

- 1.6 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bënë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim të mallit të porositur për furnizim do të jetë jo më gjatë se 40 (dyzet) ditë kalendarike pas dates së lëshimit – dërgimit të Porosisë apo Thirrjes nga ana e Autoritetit Kontraktues apo Organit tjetër të autorizuar.
- 2.2 Kontraktuesi - Furnizuesi duhet që mallin e porositur (oksigjenin medicinal) ta sjellë në sasi, cilësi përshtatshmëri dhe në pajtim me kërkesat e specifikuara në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.
- 2.3 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të liferimit të mallit sipas kësaj Kontrate dhe datës së dërgimit të Porosisë, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
- 2.4 Vendi i dorëzimit të furnizimeve do të jetë depoja qendrore e QKMF-re, ose vendi të cilin sipas nevojës e cakton më pastaj A.K.
- 2.5 QKMF-re, Menaxheri i Kontratës i A.K. në bashkëpunim dhe koordinim me personelin e QKMF-re para çdo furnizimi do të bëjë organizimin e furnizimit dhe pranimin të bombolave të oksigjenit nga Furnizuesi – Kontraktuesi deri te depoja farmaceutike, ashtu sikurse është saktësuar dhe në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.
- 2.6 Dorëzimi konsiderohet i përfunduar pas pranimin dhe konfirmimit të cilësisë së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pranuar Komisioni për pranim të mallrave dhe shërbimeve.
- 2.7 Furnizuesi i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion.
- 2.8 A.K. mbanë përgjegjësi për ruajtjen nga humbja dhe / ose dëmtimi i bombolave të O.E. A.K. do të bëjë kompensimin e bombolës së humbur dhe / ose të dëmtuar, në vlerën sipas çmimit të tregut në kohën e caktuar.

Dërgesat :

- 2.9 Dërgesat do të fillojnë të bëhen bazuar në kërkesën – porosinë e Menaxherit të Kontratës të A.K. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të A.K. , e hënë /e premte, 8.00 – 16.00 .
- 2.10 Përfundimisht nga pika 2.8, në raste specifike të veçanta dhe sipas marrëveshjes të të dy palëve, dorëzim- pranimi i bombolave të porositura mundë të bëhet edhe në ditët e vikendit dhe në kohë tjetër nga ajo e saktësuar më lartë.
- 2.5 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Artikujve dhe Çmimeve e dorëzuar nga Furnizuesi.

3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: **21.000,00€ (njëzetënjëmij/00 Euro)**.

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me sasinë e liferuar dhe të pranuar nga Menaxheri i Kontratës dhe të konfirmuar me Raportin me shkrim.

Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

3.5. Kontraktuesi ka për obligim që malli i porositur respektivisht i liferuar (oksigjeni medicinal) të jetë cilësorë, ti përmbushë në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.

3.6 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Furnizuesi të ketë përfunduar gjitha furnizimet e porositura prej Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare ;
- (d) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (e) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin: "Messer Medica
L.L.C. " – Prishtinë

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna
Vushtrri

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Arbër Merovci
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.05.2025	Data:	30.05.2025
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënim: Të përkirimit i caktuar duhet plotësohet vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vlerën si numër 0, 8, apo 18, ë jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet të plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin dublet ta shkruani me dy numra pas presjes dhjetore.

Nr.	Përkirimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
I Rregullimi i paisjeve për amviseri									
1	BOMBOJA PËR OXIGJEN 10L. Të kete certifikatën e testimit, Material nga çeliku, Vëndohet te Cromit outlet Din.W21.8x1/14 Ngjyrë e bardhë	copë	10	131.36	18.00	155.00	1,313.56	236.44	1,550.00
2	BOMBOJA PËR OXIGJEN 50L. Të kete certifikatën e testimit, Material nga çeliku, Vëndohet te Cromit outlet Din.W21.8x1/14 Ngjyrë e bardhë	copë	30	274.58	18.00	265.60	6,737.28	1,212.71	7,950.00
3	Matomëtarë Abisnashul me bombola	copë	4	38.14	18.00	45.00	152.54	27.46	180.00
4	Oksigjen i pastër medical	copë	4000	2.40	18.00	2.83	9,593.22	1,729.78	11,320.00
NËTOTALI:							17,796.61	3,203.39	21,000.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	MESSERMEDICA LLC
EMRI DHE MBEMRI I PËRFAJESUESIT TE OE:	Arber Merovci
NENSHKRIMI:	
DATA:	17.04.2025
VULA:	

